

VENDIM
Nr. 245, datë 26.11.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ReNRGY TRADING GROUP” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe nenit 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684 prot., datë 23.10.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 2.11.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën me nr. 55/65 prot., datë 2.11.2018 ka bërë njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 684/1 prot., datë 6.11.2018, ERE ka përcjellë pranë subjektit njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike për një afat 5-vjeçar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.

- Aplikimi i shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), plotësuar pjesërisht.

Germa “e” e këtij neni pa plotësuar tërësisht pasi subjekti ka përcjellë në ERE strukturën organizative që ka planifikuar të ngrejë dhe ka deklaruar se ka iniciuar procesin e rekrutimit dhe të përzgjedhjes së stafit drejtues dhe organizativ dhe planifikon të përfundojë këtë proces brenda 1 muaji nga marrja e licencës në ERE për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4.7 dhe 4.7.1). Plotësuar pjesërisht.

Pika 4.7, germa “e” pa plotësuar tërësisht pasi subjekti ka deklaruar në ERE, se do të instalojë një sistem të integruar të përshtatur nga dy ofrues të platformave për sistemet e menaxhimit të furnizimit me energji elektrike, sikurse janë Allegro dhe Unicorn.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Shoqëria brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE strukturën e

ndërtimit të shoqërisë.

3. Shoqëria përpara se të fillojë operimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të njoftojë ERE-n mbi implementimin e sistemit të platformës IT që do të përdorë.

4. Në rastin e mospërmbushjes së këtyre kushteve nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti